



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 997/1 Prot.

Tiranë, më 25.06.2025

V E N D I M

Nr. 154, Datë 25.06.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 219, datë 30.10.2024¹, e bërë nga znj. D.V kundër Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë (DVKM Tiranë) dhe Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë²” dhe “çdo shkak tjetër³” për shkak si ish konsulle e Republikës së Serbisë⁴ dhe në vijim si gazetarë e Radio Televizionit të Serbisë⁵.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 12.11.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Prej vitit 2017 jetoj dhe punoj në Republikën e Shqipërisë me ndërprerje të shkurtra, fillimisht si konsull në Ambasadën e Republikës së Serbisë në Tiranë,

¹ Ankesa është plotësuar me informacion me e-mail-in datë 12.11.2024.

² Referuar pasaportës nr.016346589, datë 27.12.2021, znj. D.V, është shtetase e Republikës së Serbisë.

³ Shtuar si pretendime nga ankuesja me email-in datë 27.01.2025.

⁴ Referuar Vërtetimit nr. 11-29/12, datë 21.02.2025 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, vërtetohet se D.V ka punuar si Këshilltare e Parë në Ambasadën e Republikës së Serbisë-Tiranë, në periudhën nga 03.09.2017 deri më 15.02.2022.

⁵ Referuar Aneksit të Marrëveshjes së Punës nr. 23-2602/8, datë 10.02.2025, të lidhur mes Radio Televizionit të Serbisë dhe D.V, në periudhën nga 02.01.2025 deri në 30.06.2025, vendi i punës së znj. V është Tirana.

për periudhën 03.09.2017 deri me 15.02.2022 dhe më pas si gazetare, korrespondente e Radio Televizionit Kombëtar të Serbisë (RTS).

Gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë kam respektuar parashikimet ligjore të ligjit nr79/2021 “Për të huajt”. Pas përfundimit të mandatit tim në Ambasadë, jam pajisur me leje qëndrimi për shkak të punës, (Leje Unike, Lëvizës Digjital nga 2022 deri me 23.10.2023).

Për shkak të ndryshimit të rrethanave të jetës, lidhjes dhe bashkëjetesës me shtetas shqiptar, vendosa të jetoj dhe të punoj në Shqipëri. Brenda afateve ligjore, me datë 09.03.2024, kam aplikuar sërish për leje qëndrimi, për shkak të punës që kryej.

Me datë 12.04.2024, jam pajisur me Leje Provizore Qëndrimi nga DVKM Tiranë, e vlefshme deri me datë 11.06.2024.

Me datë 04.07.2024, nëpërmjet thirrjes telefonike jam kontaktuar nga DVKM Tiranë, për tu paraqitur pranë zyrave të tyre. Pas paraqitjes pranë DVKM Tiranë më kanë vënë në dispozicion shkresat:

- 1. Refuzim/Heqja e Lejes së Qëndrimit për arsye se përbëj kërcënim për rendin dhe sigurinë publike në Republikën e Shqipërisë (Neni 34/1/c, Ligji 79/2021 “Për të Huajt”;*
- 2. Urdhër Largimi Nr. 38, datë 04.07.2024, për arsye se nuk plotësoj kushtet e qëndrimit në Shqipëri (Neni 99/1/a, ligji 79/2021 “Për të Huajt”. Në paragrafin 2 të këtij urdhri, është përcaktuar afati për largim nga territori, jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit, ndërsa në paragrafin 3 informohem se më ndalohet hyrja në Republikën e Shqipërisë, deri me datë 03.07.2029.*

Pas komunikimit të këtyre vendimeve, policia më mori shenjat e gishtave të dy duarve, fotot e profilit, si dhe vendosi emrin tim në sistemin TIMS.

Ndaj vendimeve të sipërpërmendura kam ushtruar të drejtën e ankimit, brenda afatit ligjor, sepse DVKM Tiranë nuk ka respektuar nenin 99, pika 5/b, nenin 99, pika 8 të ligjit “Për të huajt”.

Në përgjigje të ankesës sime, me shkresën Nr. D-17/1, datë 24.07.2024 me subjekt: “Përgjigje ankimit administrativ”, shihet qartë se vendimmarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave është e gabuar dhe e paargumentuar ligjërisht. Vendimi Nr. 282-b, datë 18.04.2024, i këtij Komisioni, lë apriori në fuqi Aktin e refuzimit të lejes së Qëndrimit, datë 04.07.2024 dhe Urdhër Largimit nr. 38, datë 04.07.2024.

Në këto kushte, duke mos qenë dakord me aktet administrative, bazuar në nenin 100, të ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt” kam paraqitur kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Shfuqizimin e akteve administrative, Pezullimin e Urdhër Largimit Nr. 38, datë 04.07.2024”. Sipas kalendarit të Gjykatës seanca e parë është përcaktuar në Shkurt 2025.

Më pas, mbështetur në Kodin e Procedurës Administrative, neni 144, pika 2, për shkak se rrethanat kanë ndryshuar, të martesës zyrtare dhe punësimin në shoqërinë “Mona Fashion”, me datë 27.08.2024, kam paraqitur kërkesë për rishikim për tu pajisur me leje qëndrimi, pranë DVKM Tiranë, si dhe DPPSH, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Duke qenë se DVKM Tiranë nuk ka kthyer përgjigje lidhur me shkresën e datës 27.08.2024, ju drejtova me e-mail datë 15.10.2024, duke i kërkuar heqjen e emrit tim nga sistemi TIMS, por sërish nuk kam marrë përgjigje.

Nga organi epror, DPPSH, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, me datë 13.10.2024, në vend të përgjigjes, lidhur me kërkesën time për rishikim të vendimmarrjes, më informon se jam e detyruar të zbatoj urdhrin e largimit, pasi është në përputhje me ligjin.

Për të pasur mundësi të jetoj dhe punoj e lirë si gjithë shtetasit e tjerë të Shqipërisë, e drejtë e cila më garantohet nga neni 5/1, i ligjit “Për të huajt”, si dhe neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me datë 15.10.2024, kam kryer një aplikim të ri për leje qëndrimi nëpërmjet portalit e-albania, për tu pajisur me leje qëndrimi me motivin e bashkimit familjar me shtetas shqiptar.

Lidhur me këtë aplikim, me datë 23.10.2024, më është komunikuar me e-mail nga DVKM Tiranë, se aplikimi im është refuzuar, me arsyetimin se aplikimi është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Duke mos qenë dakord me këtë përgjigje, me datë 24.10.2024, kam dërguar kërkesën me të cilën kërkoj që aplikimi im të rishikohet, si dhe emri im të hiqet nga sistemi TIMS.

Për shkak se emri im ndodhet në TIMS dhe e kam të pamundur të kthehem në Shqipëri në rast se dal jashtë territorit, dhe duke marrë parasysh Ligjin 79/2021 “Për të huajt”, neni 101/3, nuk jam larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë, pra arsyeja e refuzimit të kërkesës sime për leje qëndrimi në bazë të martesës me shtetas shqiptar është e pabazuar.

Megenëse nuk jam jashtë territorit të Shqipërisë (arsyeja e refuzimit) dhe nuk kam përgjigje të e-mail-it dërguar në datën 24.10.2024, kam paraqitur përsëri kërkesën time për tu pajisur me Leje Qëndrimi në datën 28.10.2024, me numër RPA-08-0000-47032CS, me motiv të bashkimit familjar.

Me e-mail-in datë 12.11.2024, DVKM Tiranë më ka njoftuar se aplikimi refuzohet, pasi nuk plotëson kushtet për qëndrim në R.SH, sipas parashikimeve të ligjit 79/2021 “Për të huajt”.

Me anë të kësaj ankese, kërkoj ndihmën dhe mbrojtjen tuaj në ushtrimin e të drejtave të mia si shtetase e huaj, sepse qëndrimi i institucioneve të administratës publike, konkretisht DVKM Tiranë dhe DPPSH-Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, më shkakton padrejtësi të madhe personale, familjare dhe profesionale, fyen reputacionin e dinjitetin tim dhe jo vetëm ndaj meje, por dhe shtëpisë mediatike, Radio Televizioni i Serbisë, si dhe kompanisë më të madhe të

modës në Serbi “Mona Fashion”, të cilën e përfaqësoj në cilësinë e administratores në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, dhënien e lejes së qëndrimit dhe heqjen e emrit nga sistemi TIMS.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁶, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Ankuesja znj. D.V, është shtetase e huaj, me shtetësi serbe, e cila qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, e pajisur me leje qëndrimi nga autoritetet përkatëse të migracionit. Në referim të nenit 4 “Subjektet”, të LMD, e ndryshuar ku përcaktohet: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”*, ankuesja legjitimohet si subjekt për të paraqitur ankesë pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

⁶ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1487/1, datë 14.11.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion të hollësishëm mbi shkakun e refuzimit të lejes së qëndrimit për aplikimet e shtetases znj. D.V (refuzimet: datë 04.07.2024 dhe për bashkim familjar datë 12.11.2024), si dhe depozitimi i akteve, që provojnë shkakun/qet e refuzimit.
 - Kopje të dokumentacionit dhe procedurën e ndjekur për trajtimin dhe shqyrtimin e aplikimeve për leje qëndrimi të kryer nga ankuesja dhe kopje të gjithë kërkesave/ankesave të ankueses dhe përgjigjeve të dhëna nga ana e institucioneve.
 - Informacion në lidhje me kuadrin ligjor, nënligjor dhe aktet e brendshme që rregullojnë të drejtën për të përfituar leje qëndrimi për bashkim familjar dhe procedurën përkatëse.
 - Cilat janë kriteret që duhet të përmbushë një person për të përfituar leje qëndrimi për bashkim familjar në Shqipëri?
 - Informacion lidhur me shtetas të tjerë nga Republika e Serbisë të cilët janë pajisur me leje qëndrimi, gjatë periudhës së viteve 2022-2024.

Me shkresën nr. D-25/7, datë 25.11.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Shtetasja Znj. D.V, ka qenë e pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë me motiv Unike Lëvizës Digjital, deri me datë 12.04.2024. Me datë 12.04.2024, ka aplikuar për rinovimin e lejes së qëndrimit dhe bazuar në Ligjin 79/2021 “Për të Huajt”, neni 34, pika 1, germa “c”, ky aplikim është refuzuar. Në vijim Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, në zbatim të Ligjit 79/2021, “Për të Huajt”, neni 99, pika 1, germa “a”, ndaj shtetases ka lëshuar Urdhër largimi për 5 (pesë) vite nga Shqipëria dhe në vijim shtetasja e sipërpërmendur ka ushtruar të drejtën e ankimit në Komisionin për shqyrtimin e ankesave/kërkesave në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin.*

Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni me Vendimin nr. 282-b, datë 18.07.2024, ka vendosur se akti i refuzimit të lejes së qëndrimit, datë 04.07.2024 dhe urdhri i largimit me nr. 38, datë 04.07.2024, lëshuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë ndaj shtetases Znj. D.V, janë në përputhje me dispozitat e Ligjit 79/2021, “Për të Huajt”.

Kundër këtij vendimi shtetasja e sipërpërmendur ka ushtruar të drejtën e ankimit në organin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, aktualisht nuk disponohet një vendim i formës së prerë nga organet kompetente gjyqësore.

Për sa i përket refuzimit të aplikimit për pajisjen me leje qëndrimi me motiv bashkim familjar, kjo shtetase nuk i plotëson kushtet për tu pajisur me leje qëndrimi bazuar në Ligjin 79/2021 “Për të Huajt”, neni 34, pika 1, germa “c”. Kriteret për pajisjen me leje qëndrimi për bashkim familjar në Republikën e Shqipërisë, janë të përcaktuara në Ligjin nr. 79/2021, “Për të Huajt”, dhe në VKM nr. 858, datë 29.12. 2021.

Për periudhën 2022-2024 kanë aplikuar për tu pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, gjithsej 207 shtetas nga Serbia, 197 aplikime janë miratuar, 7 aplikime janë në proces dhe 3 aplikime janë refuzuar.

Të ndara sipas motivit rezultojnë:

- Bashkim familjar 58.
- Të përhershme 2.
- Studim 7.
- Unike - Punëmarrës 109.
- Unike – Punësim 12.
- Të tjera 19”.

Me shkresën nr. 2672/1, datë 27.11.2024, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Shtetasja Znj. D.V ka aplikuar në DVKM-Tiranë për tu pajisur me leje qëndrimi në disa raste, më konkretisht:

- 1. Aplikim me nr. RPA-35-000028840CS, datë 19.02.2024, me motivin “Të tjera - Pronësi pasuri e paluajtshme”, refuzuar për motivin e gabuar.*
- 2. Aplikim me nr. RPA-79-000029896CS, datë 19.02.2024, me motivin “Punë”, refuzuar pasi nuk janë ngarkuar dokumentet.*
- 3. Aplikim me nr. RPA-79-000030427CS, datë 09.03.2024, me motivin “Punë”, refuzuar.*
- 4. Aplikim me nr. RPA-08-000045919CS, datë 15.10.2024, me motivin “Bashkim familjar”, refuzuar pasi ka aplikuar jashtë territorit.*
- 5. Aplikim me nr. RPA-08-000047032CS, datë 28.10.2024, me motivin “Bashkim familjar”, refuzuar pasi nuk plotësonte kushtet për qëndrim në territorin e R.SH.*

Me shkresë nr. 933/2-kl, datë 01.07.2024, jemi njoftuar nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin mbi refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi të shtetases Znj. D.V me nr.dok.283517, bazuar në praktikën shkresore nr. 2080, datë 13.06.2024, Akt nr. 933/I, datë 25.06.2024, të Drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin.

Në vijim dhe ndjekje të kësaj shkrese të klasifikuar, kërkohej marrja e masave për vazhdimin e procedurave ligjore nga ana jonë.

Për sa më sipër, nga ana jonë është njoftuar shtetasja e sipërcituar e cila është paraqitur në DVKM Tiranë, në datë 04.07.2024 dhe janë kryer procedurat ligjore, duke ju bërë me dije refuzimi i aplikimit të saj për tu pajisur me leje qëndrimi, bazuar në arsyet e shkresës së mësipërme.

Kjo shtetase nuk plotësonte më kushtet për të qëndruar në R.SH, në zbatim të nenit 99, të Ligjit 79/2021 “Për të huajt”, u përpilua edhe Urdhri i Largimit nr. 38, datë 04.07.2024 dhe akti i Refuzimit të Lejes së Qëndrimit.

Shtetasja ka nënshkruar këto akte, duke marrë njoftim dhe dijeni të plotë për arsyet ligjore mbi refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi, arsye të cilat specifikohen në akt që edhe vetë shtetasja e disponon pasi e ka ankimuar konform ligjit.

Me shkresën nr. K-4833, datë 27.08.2024, është depozituar në DVKM-Tiranë kërkesë e bërë nga shtetasja Znj. D.V, shtetase Serbe lindur në Prishtinë (e cila i drejtohej edhe Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH), në të cilën citonte arsyet e saj dhe kërkonte rishikimin e vendimit për leje qëndrimi dhe të Urdhrit të Largimit nr. 38, datë 04.07.2024 të nxjerrë nga ana jonë, pra DVKM-Tiranë.

Sërish është njoftuar shtetasja nëpërmjet bashkëshortit të saj, i cili paraqitej në DVKM Tiranë, se nuk ishte më e drejtë ligjore që një akt i nxjerrë nga ana jonë të rishikohej po nga ne, ndaj duke qenë se kjo kërkesë i ishte drejtuar edhe Komisionit të Ankesave në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin si instancë eprorë, atëherë duhet të prisnim qëndrimin dhe përgjigjen e tyre mbi ankesën konkrete të shtetasës.

Në këtë shkresë shtetasja bashkëlidh dhe një vendim gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. 151, datë 31.07.2024 “Për sigurimin e padisë”, por në dispozitivin e saj, pas shqyrtimit të të gjithë situatës dhe kërkesave të palës, ishte vendosur rrëzimi i kërkesës për sigurimin e padisë.

Ky vendim na është njoftuar edhe vetë nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kopje të të cilave janë dërguar në Seksionin Juridik të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, të cilët përfaqësojnë edhe DVKM-Tiranë në seancat gjyqësore.

Me shkresën e protokolluar me tonën nr. K-8095, datë 25.10.2024 shtetasja Znj. D.V me kërkesë ankimore e cila i drejtohej sërish DPPSH-së, Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, kërkonte pajisjen e saj me leje qëndrimi dhe heqjen e ndalesës nga sistemi TIMS.

Edhe kësaj kërkesë i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 8095/1, datë 15.11.2024, duke ju sqaruar situata në të cilën gjendej”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 06.12.2024 dhe datë 10.12.2024, është njohur me përgjigjet e DPPSH dhe DVKM Tiranë.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga DPPSH, ankuesja me email-in datë 08.12.2024, informoi si vijon: “Fillimisht thuhet që kam qenë e pajisur me Leje Qëndrimi deri në datën 12.04.2024 dhe kam aplikuar për rinovim po në të njëjtën datë. Këto të dhëna nuk janë të sakta pasi

unë kam qenë e pajisur me leje qëndrimi deri në 18.10.2023, dhe kam riaplikuar në datën 09.03.2024.

Përsa i përket refuzimit të aplikimit për pajisjen me leje qëndrimi me motiv bashkim familjar i referohet Ligjit 79/2021 dhe VKM nr. 858, datë 29.12.2021, në mënyrë eksplicite sqarohet dokumentacioni dhe procedura të cilat unë i plotësoj në mënyrë të plotë dhe nuk ka asnjë arsye refuzimi!

Në Ligjin për të Huajt, në asnjë nen nuk thuhet se nëse refuzohet leja e qëndrimit në bazë të nenit 34/1/c, apo me ndonjë nen tjetër, nuk mund të aplikojë sërish, për leje qëndrimi për arsye tjetër.

Në dy aplikimet që kam bërë për leje qëndrimi me motiv bashkim familjar, më janë kthyer përgjigje të ndryshme: në rastin e parë thuhet që nuk mund të aplikoj, pasi jam jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në rastin e dytë i referohet Ligjit 79/2021, pa asnjë sqarim. Për sa më sipër Drejtoria Vendore duhet të merrte në shqyrtim dy kërkesat e mia për leje qëndrimi në bazë të martesës me shtetas shqiptar, megjithatë u refuzuan në kundërshtim me të gjitha konventat dhe aktet e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu neni 101, paragrafi 3, i ligjit “Për të huajt” thotë se urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, por Drejtoria e Policisë së Tiranës më ndaloi hyrjen në Shqipëri prej 5 vitesh dhe emri im është vendosur në sistemin TIMS, kjo më pengon të lëviz lirshëm dhe të udhëtoj për të takuar fëmijët që jetojnë në Serbi.

A nuk është ky diskriminim dhe shkelje e të drejtave të njeriut në emër të referimit të një neni të ligjit, që nuk shpjegon asgjë dhe që nesër mund të thonë është sekret shtetëror?!”.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga DVKM Tiranë, ankuesja me email-in datë 11.12.2024, informoi si vijon: “Për herë të parë kam dëgjuar shkresë të klasifikuar, për të cilën nuk e di realisht kuptimin e saj, si dhe nuk e kuptoj se përse më refuzohet leja e qëndrimit për sa kohë që gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë kam respektuar ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi.

DVKM Tiranë, në mënyrë të padrejtë shprehet se nuk mund të kërkojë rishikimin e kërkesës sime duke qenë se rishikimi bëhet nga organi epror. Në kërkesën për rishikim, i kam bërë me dije se jam e martuar me një shtetas shqiptar dhe për këtë fakt ata duhet të më pajisnin me leje qëndrimi konform legjislacionit në fuqi. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për të mos më pajisur me leje qëndrimi dhe arsyeja se ka një shkresë të klasifikuar, shkresë që nuk e kuptoj se cili institucion e ka lëshuar dhe për cilin shkak.

Kërkoj ndihmën tuaj, pasi dua të jetoj jetën time bashkë me bashkëshortin tim në Shqipëri dhe të kem të drejtën e lëvizjes së lirë (të hiqem nga TIM-s) për të takuar djemtë e mi të mitur që jetojnë në Serbi, pasi vendimet e marra nga këto institucione janë arbitrare dhe fakti i kësaj shkrese e klasifikuar po më dëmton të drejtën për të jetuar dhe gëzuar e qetë jetën time”.

Me email-in datë 13.01.2025, ankuesja informoi si vijon: *“Dua t’ju bëj me dije se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas kërkesës sime për pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Urdhër largimi Nr. 38, datë 07.04.2024, Gjykata ka vendosur me datë 17.12.2024, pranimin e kërkesës sime, pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Urdhër Largimi Nr. 38, datë 07.04.2024 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin.*

Në dispozitivin e gjykatës është shprehur se Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin si dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë duhet të ekzekutojnë menjëherë këtë vendim.

Edhe pse gjykata ka vendosur kështu, unë ende e kam të pamundur të lëviz jashtë territorit të Shqipërisë për shkak se emri im nuk është hequr nga sistemi TIM-s, duke më mohuar të drejtat e mia dhe duke moszbatuar vendimin e Gjykatës.

Nga ana ime është informuar Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin për heqjen e emrit tim nga sistemi TIM-s, por nga ana e tyre është neglizhuar personi im, si dhe nuk kanë përmbushur detyrën funksionale sipas së cilës ata duhet që të zbatojnë vendimin e gjykatës që është në favorin tim, duke treguar diskriminim që kanë ndaj një shtetase serbe”.

Me email-in datë 27.01.2025, ankuesja ka informuar Komisionerin duke pretenduar se: *“Dua të informoj që Drejtoria e Policisë akoma nuk ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës Administrative dhe në të njëjtën kohë ka bërë ankimim të veçantë në Gjykatën e Apelit me arsyetimin që është sekret shtetëror.*

E gjitha kjo tregon që diskriminohem si ish konsulle e Republikës së Serbisë dhe në vijim si gazetarë e Radio Televizionit të Serbisë. Është e dukshme që Drejtoria e Policisë më diskriminon për shkak të detyrës së mëparshme dhe asaj aktuale. Ju lutem shqyrtoni kërkesën time duke u bazuar në këto rrethana”.

- Me shkresën nr. 169, datë 22.01.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, informacion mbi masat e marra për zbatimin e Vendimin nr.Regj.Them. 9575, datë 17.12.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Me shkresën nr. 706/1, datë 04.02.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mes të tjerash informoi se: *“Bazuar në Ligjin 79/2021, “Për të Huajt”, neni 34, pika 1, germa “c”, neni 99, pika 1, germa “a”, shtetases Znj. D.V, me datë 04.07.2024, i është refuzuar leja e qëndrimit, dhe njëkohësisht DVKM Tiranë, ka nxjerrë urdhër largimi nr. 38, datë 04.07.2024, me ndalim hyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë deri me datë 03.07.2029, shkresë e cila i është dërguar edhe Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave për vendosjen e njoftimit në kufi.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, fillimisht me Vendim nr. 151 regjistri themeltar, datë 31.07.2024, “Për sigurimin e padisë”, pas shqyrtimit të gjithë situatës dhe kërkesave të palës, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Me vendim nr. 9575, datë 17.12.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur pranimi i kërkesës për marrjen e sigurimit të padisë dhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, Urdhër Largimit nr. 38, datë 04.07.2024 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë.

Me shkresë nr. 1611, datë 13.01.2025, ky vendim është përcjellë dhe trajtuar dhe nga seksioni juridik në DVP-Tiranë, të cilët përfaqësojnë edhe DVKM-Tiranë në procese gjyqësore, me qëllim përmbushjen e të drejtës për ankim të veçantë brenda afatit ligjor 5-ditor, bazuar kjo në pikën 5, të dispozitivit të këtij vendimi.

Njëkohësisht me shkresën nr. 166/1, datë 28.01.2025, drejtuar Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, është kërkuar anulimi i shënimit në rubrikën “Njoftim në kufi”, njoftim i cili aktualisht rezulton me status “anuluar”, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar gjyqësor për shtetasen Znj. D.V.

Me shkresën Nr. 155/l, datë 30.01.2025, është kthyer përgjigje shtetases së sipërcituar mbi kërkesën e saj drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (shkresa Nr. D-1/1 prot, datë 22.01.2025 është përcjellë në DVKM-Tiranë për trajtim dhe kthim përgjigje). Shënimi “Njoftim në kufi” në asnjë moment nuk përbën pengesë ligjore për daljen nga territori i R.SH të shtetases Znj. D.V, dhe vlen t’ju sqarojmë se edhe pas anulimit të këtij shënimi në zbatim të vendimit gjyqësor, sërish shtetasja duhet të respektojë afatet ligjore të qëndrimit në territorin e R.SH.

Në përmbushje të detyrimit institucional, në respektim të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ju informojmë se nga ana jonë çdo procedurë e mbajtur ka qenë në mbështetje dhe përmbushje të plotë të ligjit dhe për asnjë shkak, cilësi apo rrethanë e trajtuar ndryshe për t’u ndjerë e diskriminuar”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 330, datë 17.02.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 26.02.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja znj. D.V, e asistuar nga përkthyesja znj. E.J, dhe palëve kundër së cilëve është paraqitur ankesa, përfaqësuesve të Drejtorisë

së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, znj. E.P dhe F.K, përfaqësueses së Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, znj. J.Xh.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, ndërkohë që në mes të tjerash deklaroi se: *“Çdo aplikim për paisje me leje qëndrimi në RSH, kalon për vlerësim në disa institucione të tjera ligjbatuese. Aplikimet bëhen në e-albania dhe çdo qytetar i huaj vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi. Pas shqyrtimit të dokumenteve përkatës nga Drejtoria Vendore e Policisë Kufitare, nëse dokumentacioni rezulton i rregullt, çdo i huaj dërgon dokumentacionin origjinal me postë dhe pasi dosja është e plotë, kalohet nëpërmjet sistemit FER (rregjistri elektronik për të huajt), në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin. Departamenti kalon të gjitha aplikimet për vlerësim dhe miratim tek Drejtori i Departamentit. Pasi vlerësohen dhe miratohen dërgohen në institucionet e tjera ligjbatuese për vlerësimin përkatës. Për një periudhë 30 ditë, këto aplikime kthehen përsëri në sistemin FER, të vlerësuara pozitivisht ose negativisht dhe ky vlerësim shfaqet në sistem. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin mund të njoftohet ose jo me shkresë zyrtare për çdo refuzim të bërë nga institucionet e tjera ligjbatuese. Në rastin e ankueses, jemi njoftuar nga institucioni përkatës, por ne nuk kemi informacion për çfarë është refuzuar ankuesja. Pra institucioni ligjbatues nuk jep informacion, vetëm dërgon një shkresë, në të cilën njofton që shtetasi në fjalë është refuzuar, bazuar në nenin 34/1/c, që është cënim për rendin dhe sigurinë kombëtare. Pas këtij refuzimi njoftohet Drejtoria Vendore dhe kjo e fundit harton urdhrin e largimit në bazë të ligjit. Lidhur me urdhrin e largimit për ankuesen, informoj se ky urdhër nuk ka pasur për bazë të ndalojë shtetasen të largohet nga territori, pra të takojë fëmijët e saj, por ky urdhër largimi ka qenë për ndalim hyrje në RSH, jo ndalim dalje”.*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi se: *“Me marrjen e urdhrin të largimit në datë 04.07.2024, znj. D.V e ka kundërshtuar në gjykatë dhe në korrik, gjykata e ka rrëzuar sigurimin e padisë, ndërsa në dhjetor gjykata ka pranuar sigurimin e padisë. Gjatë kësaj periudhe ankuesja mund të kishte dalë nga territori, për të takuar fëmijët e saj dhe këtu mund të përfaqësohej me avokat, për të mbrojtur të drejtat e saj.*

Urdhri i largimit është që shtetasi duhet ta zbatojë vetë, vullnetarisht dhe jo forcërisht i bërë nga policia. Ankuesja ka ardhur disa herë pranë institucionit, për të marrë informacion për ankimet që ka bërë në institucione dhe gjykatë dhe e kam pritur dhe sqaruar.

Kur ka marrë refuzimin për aplikimin për bashkim familjar, në tetor 2024, me arsyen se ka aplikuar nga jashtë, znj. D.V, ka pasur mundësinë që të paraqitej pranë Drejtorisë Vendore dhe të bënte deklaratën e prezencës, që është në Shqipëri dhe të merrej sërish në shqyrtim kërkesa e saj”.

- Me e-mail-in datë 11.03.2025, subjekti ankues në mes të tjerash ka pretenduar se: “.... Dëshiroj t’ju bëj të ditur se Serbia, sipas Kushtetutës së saj, është shtet i popullit Serb dhe i të gjithë qytetarëve që jetojnë në të. Në këtë drejtim, në Republikën e Serbisë jetojnë 24 pakica kombëtare, duke përfshirë shqiptarët që jetojnë në pjesën jugore të vendit, në Preshevë dhe Bujanoc. Prandaj do të doja një përgjigje më konkrete përsa i përket numrit të Serbëve që kanë aplikuar për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, sesa numrit të shtetasve serbë.

Kur bëhet fjalë për diskriminimin etnik, ka një dallim të madh nëse kërkesat për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë janë dorëzuar nga shtetas serbë (që i përkasin grupit etnik shqiptar ose një tjetër prej 24 grupeve etnike që jetojnë në Serbi), ose nga serbët etnikë”.

- Me shkresën nr. 330/3, datë 03.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Tiranë, informacion si më poshtë:
 - A ka gazetarë/korrespondentë nga Republika e Serbisë dhe nga shtete të tjera, që janë pajisur me leje qëndrimi pune dhe leje qëndrimi për bashkim familjar, gjatë periudhës së viteve 2022-2024. Kush është procedura dhe a kanë një status të veçantë gazetarët/korrespondentët e huaj për tu pajisur me leje qëndrimi pune.
 - A ka ish diplomatë nga Republika e Serbisë dhe nga shtete të tjera, që janë pajisur me leje qëndrimi pune dhe leje qëndrimi për bashkim familjar, gjatë periudhës së viteve 2022-2024. Kush është procedura dhe a kanë një status të veçantë ish diplomatët për tu pajisur me leje qëndrimi pune.
 - Informacion duke specifikuar, sa nga 207 shtetasit që kanë aplikuar për leje qëndrimi, janë shtetas nga Republika e Serbisë dhe sa janë shtetas të minoritetit Serb në Kosovë.
 - Informacion duke specifikuar, sa nga 207 shtetasit nga Republika e Serbisë që kanë aplikuar për leje qëndrimi, janë shtetas që kanë lindur në Kosovë dhe sa janë shtetas Serb që kanë lindur në Republikën e Serbisë.

Me shkresën nr. 786/1, datë 16.04.2025, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë ka kompetencë shqyrtimin e aplikimeve mbi pajisjen me leje qëndrimi për shtetas që banojnë/punojnë në territorin nën juridiksion territorial të Tiranës, përsa i përket çështjeve për Kufirin dhe Migracionin.*

Për sa më sipër, lidhur me kërkesat e cituara në shkresën tuaj, ju bëjmë me dije se gjatë periudhës 2022-2024 në DVKM-Tiranë kanë aplikuar nëpërmjet sistemit online e-albania një numër prej:

- 81 shtetas të huaj me shtetësi Serbe, nga të cilët:
- 28 aplikime janë me motivin “Bashkim familjar”;
- 3 aplikime motiv “Studimi”;
- 50 aplikime për leje unike motivi “Punëmarrës/i vetëpunësuar.

Përsa i përket këtij database, nuk mund të evidentohet nga ana jonë se sa prej këtyre shtetasve me shtetësi Serbe kanë profesion gazetarinë apo janë korrespondentë, pasi sistemi nuk e ka këtë formë kërkimi.

Lidhur me kërkesën tuaj, nëse ka ish diplomatë nga Republika e Serbisë dhe nga shtete të tjera që janë pajisur me leje qëndrimi, ju bëjmë me dije se bazuar nenit 3, pika 3, e Ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt”, kjo procedurë ndiqet nga Protokolli i Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

Gjithashtu, ju informojmë se për periudhën 2022-2024, nga ana e DVKM-Tiranë nuk ka pasur ndonjë rast tjetër të nxjerrjes së urdhër largimi për shtetas me shtetësi Serbe, fakte këto që tregojnë se në asnjë moment nuk ka qenë dhe nuk mund të ndodhë të konsiderohet diskriminim për asnjë lloj shkak apo arsyeje ndaj çdo shtetasi të huaj apo pa shtetësi të cilët janë objekt i zbatimit të ligjit”.

Me shkresën nr. 2860/1, datë 22.04.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Duke filluar nga viti 2023, të gjitha aplikimet për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë bëhen vetëm nëpërmjet platformës online, portalit qeveritar e-albania. Çdo shtetas i huaj ose një person i autorizuar prej tij, aplikon për tu pajisur me leje qëndrimi, zgjedh motivin e caktuar dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 79/2021, “Për të Huajt” dhe VKM nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Lidhur me pyetjen: “A ka gazetarë/korrespondentë nga Republika e Serbisë dhe nga shtete të tjera, që janë pajisur me leje qëndrimi pune dhe leje qëndrimi për bashkim familjar, gjatë periudhës së viteve 2022-2024? Kush është procedura dhe a kanë një status të veçantë gazetarët/korrespondentët e huaj për tu pajisur me leje qëndrimi pune?”, ju informojmë se:*

Bazuar në Ligjin nr. 79/2021, “Për të Huajt”, shtetasit e huaj aplikojnë për leje qëndrimi sipas motivit (nenin 39), kurse profesioni përcaktohet në kontratën e punës si pjesë e dokumenteve të kërkuara sipas kritereve ligjore për aplikimin dhe pajisjen me leje unike pune. Kjo e dhënë nuk mund të gjenerohet nga sistemi FER (Regjistri Elektronik për të Huajt).

- Lidhur me pyetjen: “A kanë një status të veçantë gazetarët/korrespondentët për tu pajisur me leje qëndrimi pune?”, ju informojmë se:*

Bazuar në Ligjin nr. 79/2021, “Për të Huajt” dhe në VKM nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk gëzojnë status të veçantë.

- Lidhur me pyetjen: “A ka ish diplomatë nga Republika e Serbisë dhe nga shtete të tjera, që janë pajisur me leje qëndrimi pune dhe leje qëndrimi për bashkim familjar, gjatë periudhës së viteve*

2022-2024?. Kush është procedura dhe a kanë një status të veçantë ish diplomatët për tu pajisur me leje qëndrimi pune?”, ju informojmë se:

Gjatë aplikimit për pajisjen me leje qëndrimi, zgjidhet motivi dhe ngarkohet dokumentacioni sipas kërkesave të motivit të përzgjedhur nga ana e aplikantit. Në aplikim nuk përfshihet statusi aktual apo i mëparshëm, diplomat ose jo. Gjithashtu, ju informojmë se pajisja me leje qëndrimi e trupit diplomatik në Republikën e Shqipërisë, bëhet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Lidhur me informacionin e kërkuar duke specifikuar, sa nga 207 shtetasit që kanë aplikuar për leje qëndrimi, janë shtetas nga Republika e Serbisë dhe sa janë shtetas të minoritetit Serb në Kosovë, dhe informacion duke specifikuar, sa nga 207 shtetasit nga Republika e Serbisë që kanë aplikuar për leje qëndrimi, janë shtetas që kanë lindur në Kosovë dhe sa janë shtetas që kanë lindur në Republikën e Serbisë?”, ju informojmë se:

Aplikimi për pajisjen me leje qëndrimi bëhet nëpërmjet portalit e-albania dhe automatikisht merr shtetësinë e aplikantit dhe shtetin e dokumentit me të cilin ka aplikuar shtetasi i huaj dhe për këtë arsye nuk mund të përcaktohet se sa nga këta shtetas janë nga Republika e Serbisë dhe sa janë shtetas të minoritetit Serb në Kosovë apo anasjelltas.

Siç ju kemi informuar, për periudhën 2022-2024 kanë aplikuar për tu pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë gjithsej 207 shtetas nga Serbia, 197 aplikime janë miratuar, 7 aplikime janë në proces dhe 3 aplikime janë refuzuar.

Të ndara sipas motivit rezultojnë:

- Bashkim familjar 58 leje qëndrimi;
- Të përhershme 2 leje qëndrimi;
- Studim 7 leje qëndrimi;
- Unike-Punëmarrës 109 leje qëndrimi;
- Unike-Punësim 12 leje qëndrimi;
- Të tjera 19 leje qëndrimi.

Procedura për pajisjen me leje qëndrimi me motiv “leje unike” përcaktohet në Ligjin nr. 79/2021 “Për të Huajt”, Seksioni V, neni 56 dhe “Leja e qëndrimit për bashkim familjar”, Seksioni III, neni 40 dhe në VKM nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu, dëshirojmë t’ju informojmë se riaplikimi i datës 21.02.2025, znj. D.V, për pajisjen me leje qëndrimi, është miratuar me datë 16.04.2025”.

Më përgjigje të shkresave të dërguara nga DPPSH dhe DVKM Tiranë, ankuesja me e-mail-in datë 07.05.2025, informon se nuk është dakord me përgjigjet, pasi institucionet e zotërojnë informacionin, por e shmangin përgjigjen për informacionin e kërkuar nga Komisioneri. Gjithashtu

ankuesja konfirmoi se aplikimi i pestë për bashkim familjar ishte pranuar dhe ishte pajisur me leje qëndrimi për një vit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e DPPSH-së, Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë dhe më konkretisht në lidhje me aplikimin për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurat në lidhje me aplikimin për pajisje me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 79, datë 24.06.2021 “*Për të huajt*” rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit të kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

Sipas nenit 2, pika 1, të këtij ligji, subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe në rastet kur dalin nga Republika e Shqipërisë. Në kuptim të nenit 3, pika 9, të këtij ligji “*I huaj*” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Neni 4 i ligjit të sipërcituar përcakton autoritetet përgjegjëse mbi çështje që kanë të bëjnë me të huajt. Kështu në bazë të pikës 1, të këtij nenit autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet në Republikën e Shqipërisë është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin. Sipas pikës 11, të tij, autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e sigurisë kombëtare është struktura që mbulon shërbimin informativ shtetëror në nivel qendror, ndërsa në bazë të pikës 12, të nenit 4, autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike është struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, autoritetet shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e të huajve janë strukturat përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, strukturat e rendit e të sigurisë publike në Policinë e Shtetit, si dhe zyrat përgjegjëse për gjendjen civile.

Në kuptim të nenit 31 të këtij ligji, i huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë afatshkurtër, për një periudhë të përkohshme, si dhe të përhershme. Qëndrimi për një periudhë afatshkurtër nuk mund të kalojë afatin 90 ditë për 180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë, përjashtuar kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në marrëveshje të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëndrimi për një periudhë të përkohshme dhe të përhershme mund të realizohet vetëm nëpërmjet pajisjes të të huajit me leje qëndrimi.

Në nenin 32 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt” parashikohen llojet e lejeve të qëndrimeve. Në këtë nen parashikohet se: *“1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me njërën nga llojet e lejeve të qëndrimit të mëposhtme të huajt, të cilët kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat më shumë se 90 ditë në 180 ditë dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj: a) leje qëndrimi e tipit “A”, e cila i jep të drejtën mbajtësit vetëm të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit kohor për të cilën ajo lëshohet; b) leje qëndrimi ose leje unike e tipit “B”, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;”*.

Në kuptim të nenit 33, të këtij ligji, i huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë me një vizë qëndrimi afatgjatë të tipit “D”, ose ai që hyn pa vizë, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj ose në marrëveshje ndërkombëtare, i bën një kërkesë online autoritetit vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin për t’u pajisur me leje qëndrimi. Për personat që hyjnë me vizë, motivi i lejes së qëndrimit duhet të përputhet me motivin e vizës, me të cilën i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.

Në pikat 2-3 të këtij neni përcaktohet se autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pas konsultimit me Shërbimin Informativ të Shtetit dhe shërbimet e rendit dhe sigurisë, miraton leje qëndrimi, ndërsa autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal/vendor për trajtimin e të huajve i lëshon të huajit lejen e qëndrimit.

Bashkëpunimi për procedurat e lëshimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe ministrisë përgjegjëse për financat e ekonominë përcaktohet me udhëzim të përbashkët të këtyre institucioneve.

Në nenin 34, pika 1 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt” parashikohen shprehimisht rastet e refuzimit të kërkesës së lejes së qëndrimit, të cilat citohen si më poshtë:

“1. Lëshimi ose ripërtëritja e lejes së qëndrimit mund të refuzohet ose mund të anulohet nëse:

a) i huaji nuk ka arritur ta dorëzojë kërkesën apo të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të përcaktuar dhe nuk paraqet arsye të besueshme që të justifikojë moskryerjen e këtij veprimi;

b) i huaji nuk është në gjendje të vërtetojë se plotëson ose nuk plotëson më kushtet e kërkuara për qëndrim, sipas kritereve të kërkuara;

c) i huaji përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe është bërë subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë;.....”.

Në nenin 34, Pika 3, parashikohet se: “Refuzimi i lëshimit, ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit i njoftohet kërkuesit/mbajtësit me shkrim, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe duhet të përmbajë, ndër të tjera, arsyen e refuzimit, detyrimet që rrjedhin për të huajin si pasojë e refuzimit të lëshimit, ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit, si dhe të drejtën e ankimit, afatet dhe autoritetin ku drejtohet ankimi administrative”.

Në nenin 35, parashikohet se: “1. Kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. 2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi”.

Në nenin 40, parashikohet se: “1. I huaji, i cili është anëtar i familjes së një shtetasi/e shqiptar/e, pajiset me leje qëndrimi me afat jo më shumë se një vit për herë të parë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje apo në këtë ligj. Leja e qëndrimit ripërtërihet më pas për një periudhë dyvjeçare. Ky përcaktim për bashkëshortin/en e një shtetasi/e shqiptar/e vlen edhe për të miturin, i cili nuk është i martuar dhe për të cilin i huaji është kujdestar ligjor”.

Në nenin 68, parashikohet se: “Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin e pajis të huajin me “leje unike qëndrimi për punonjës lëvizës (digital)” me afat deri në 1 vit, për herë të parë, në rastet kur shtetasi i huaj është me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe: a) provon me kontratë të vlefshme punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit; b) provon se ka të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë; c) zotëron dëshmi të akomodimit dhe adresës në Republikën e Shqipërisë; ç) ka një policë të sigurimit shëndetësor të vlefshme për të paktën 1 vit; d) zotëron një certifikatë/dëshmi penalteti nga vendi i tij i origjinës, ku detajohet nëse ka apo jo një rekord penal”.

Në nenin 99, parashikohet se: “1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin lëshon urdhrin e largimit për të huajin kur: a) nuk plotëson më kushtet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në këtë ligj;4. Ekzekutimi i urdhrit të largimit për kategori të ndryshme të të huajve me qëndrim të parregullt kryhet si më poshtë: a) b) për të huajin që i është anuluar apo revokuar viza, ose i është refuzuar rinovimi i lejes së qëndrimit, ose i është anuluar ose revokuar leja e qëndrimit për një afat jo më shumë se 30 ditë nga data e njoftimit..... 9. Të huajit i njoftohet në formë të shkruar, sipas procedurave të Kodit të Procedurës Administrative, në gjuhën që kupton, ose së paku në gjuhën angleze, urdhri i largimit, duke e njohur

me procedurat e ankimit, sipas nenit 100 të këtij ligji. Formatit dhe përmbajtja e urdhrit të largimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Në neni 100, parashikohet se: *“I huaji, subjekt i një urdhri largimi, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi”.*

Në neni 101, pika 3, parashikohet se: *“Urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në këtë ligj”.*

Në VKM nr. 858, datë 29.12.2021 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë: “III. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi. A. Kriteret të përgjithshme dhe procedurat për t’u pajisur me leje qëndrimi:*

1. Kërkesa për lëshimin e lejes së qëndrimit ose për ripërtëritjen e saj, si dhe miratimi i kërkesës bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt on-line. 1/1 Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 5 ditëve të huajin me leje provizore.

Nga këqyrja e dokumentacionit, informacionit të dërguar dhe fakteve rezulton se:

Ankuesja Znj. D.V, është shtetase e Republikës Serbe, e lindur në Prishtinë, dhe për periudhën 03.09.2017 deri më 15.02.2022, ka punuar si Këshilltare e Parë në Ambasadën e Republikës së Serbisë në Tiranë, dhe më pas si gazetare Radio Televizionit të Serbisë, në Tiranë. Referuar formularit të aplikimit për leje qëndrimi RPA-79-000030427CS, datë 09.03.2024, por dhe deklarimit të ankueses me email-in datë 08.12.2024, rezulton se ankuesja për periudhën nga data 18.10.2022 deri në datë 18.10.2023, ka qenë e pajisur me leje qëndrimi një vjeçare.

Ankuesja me aplikimin RPA-79-000030427CS, datë 09.03.2024, ka aplikuar për tu pajisur me Leje Unike-Lëvizës Digjital.

DVKM Tiranë, në datë 12.04.2024, ka nxjerrë aktin Leje Qëndrimi për të Huajt, Provizore, për kërkuesen Znj. D.V, e vlefshme deri në datë 11.06.2024.

Me datë 04.07.2024, ankuesja është njoftuar dhe ka marrë dijeni nga DVKM Tiranë, për Refuzimin/heqjen e Lejes së Qëndrimit për arsye se *përbënte kërcënim për rendin dhe sigurinë publike në Republikën e Shqipërisë* (Neni 34/1/c, Ligji 79/2021 “Për të Huajt”;

Po në të njëjtën ditë ka dalë dhe Urdhër Largimi nr. 38, datë 04.07.2024, në mbështetje të ligjit 79/2021 “Për të Huajt”, neni 99/1/a, për arsye se *nuk plotëson kushtet e qëndrimit në Shqipëri*. Në pikën 2 të këtij urdhri, është përcaktuar afati për largim nga territori, jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit, në pikën 3, informohet se shtetases i ndalohet hyrja në Republikën e Shqipërisë, deri me datë 03.07.2029, ndërsa në pikën 4, është informuar se mund të bënte ankesë mbështetur në nenin 100, të ligjit 79/2021 “Për të huajt”.

Ankuesja ka ushtruar të drejtën e saj të ankimit kundër akteve të sipërcituara pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nëpërmjet ankimit të datës 08.07.2024.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë DPPSH, me shkresën nr. D-17/1, datë 24.07.2024, ka njoftuar znj. D.V, se: *“Komisioni i shqyrtimit të ankesave me Vendimin nr. 282-b, datë 18.07.2024, vendosi se Akti i refuzimit të lejes së qëndrimit, datë 04.07.2024 dhe Urdhri i Largimit për 5 vite nga Shqipëria, me nr. 38, datë 04.07.2024, lëshuar nga DVKM Tiranë, ndaj shtetases Znj. D.V, janë në përputhje me dispozitat e ligjit “Për të huajt”. Bazuar në nenin 73/2 dhe 100 të ligjit “Për të huajt”, ju keni të drejtën e ankimit për shfuqizimin e këtyre akteve, në organet gjyqësore të R.SH”.*

Ankuesja duke mos qenë dakord me aktet administrative, bazuar në nenin 100, të ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt”, në datë 30.07.2024, ka paraqitur kërkesë padë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt *“Shfuqizimin e akteve administrative, Pezullimin e Urdhër Largimit nr. 38, datë 04.07.2024”.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendim nr. 151, datë 31.07.2024, *“Për sigurimin e padisë”*, pas shqyrtimit të gjithë situatës dhe kërkesave të palës, vendosi rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Ankuesja me shkresën datë 27.08.2024, ka paraqitur kërkesë për rishikim për tu pajisur me leje qëndrimi, pranë DVKM Tiranë, si dhe DPPSH, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

DKM me shkresën nr. D-25/1, datë 07.10.2024, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke e informuar për vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe i ka kërkuar zbatimi i urdhrit të largimit.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10/2023 *“Për informacionin e klasifikuar”*, strukturat e migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin ndjekin me rigorozitet procedurën e mirëpërcaktuar për trajtimin e rasteve të refuzimit të lejes së qëndrimit për shkak të cënimit të rendit dhe sigurisë publike nga i huaji, duke i njoftuar të huajt vetëm bazën ligjore, të cilës i referohet ky refuzim, ndërkohë që nuk lejohet t’i komunikohet informacioni origjinal i klasifikuar apo struktura e burimit të këtij informacioni⁷.

Referuar korrespondencës me Departamentin për Kufirin dhe Migracionin dhe me DVKM Tiranë, rezulton se strukturat qendrore dhe vendore të Kufirit dhe Migracionit, të cilat kanë trajtuar aplikimin për rinovimin e lejes së qëndrimit të kësaj shtetase nuk kanë dijeni mbi motivin e saktë të refuzimit të lejes së qëndrimit të shtetases Znj. D.V. Ky informacion konsiderohet i klasifikuar dhe mund t’i njoftohet nga struktura burim, vetëm strukturave superiore në Policinë e Shtetit apo Ministrinë e Brendshme, me kërkesë të tyre.

⁷ Neni 6: *“2. E drejta e njohjes me informacionin e klasifikuar kufizohet vetëm tek ata persona që kanë nevojë për njohje dhe përmbushin kriteret e sigurisë. 3 Një institucion nuk ka të drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër pa autorizimin e këtij të fundit”.*

Ankuesja me formularin nr. RPA-08-000045919CS, datë 15.10.2024, ka aplikuar për leje qëndrimi, me motivin e bashkimit familjar me bashkëshortin⁸.

Lidhur me aplikim e mësipërm, DVKM Tiranë me email-in datë 23.10.2024, ka informuar ankuesen se aplikimi për leje qëndrimi është refuzuar, për arsye se aplikimi është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ankuesja e kundërshton këtë arsye, duke informuar se ka qenë në territorin e R.SH. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e DVKM Tiranë, informoi se nëse znj. D.V ka qenë në Shqipëri, atëherë *ka pasur mundësinë që të paraqitej pranë Drejtorisë Vendore të bënte deklaratën e prezencës, dhe pastaj mund ti merrej përsëri në shqyrtim kërkesa e saj.*

Ankuesja me kërkesën datë 23.10.2024, drejtuar DPPSH dhe DVKM Tiranë, ka kërkuar, pajisjen me leje qëndrimi dhe heqjen e ndalesës nga sistemi TIMS.

DVKM Tiranë me shkresën nr. 8095/1, datë 15.11.2024, ka informuar ankuesen se: *“Sipas Vendimit nr. 151, datë 31.07.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës suaj për sigurimin e padisë, lidhur me pezullimin e ekzekutimit të Urdhrit të largimit nr. 38, datë 04.07.2024. për sa më sipër ju bëjmë me dije se duhet të zbatoni detyrimet e Urdhrit të Largimit”.*

Ankuesja me formularin nr. RPA-08-000047032CS, datë 28.10.2024, ka aplikuar për leje qëndrimi, me motivin e bashkimit familjar me bashkëshortin.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë DPPSH, me shkresën nr. D-25/4, datë 18.11.2024, ka njoftuar znj. D.V, se: *“...bazuar në nenin 73/2 dhe nenin 100 të ligjit 79/2021 “Për të huajt”, ju keni të drejtën e ankimit në organet gjyqësore të R.Sh. Deri aktualisht nuk disponojmë një vendim të formës së prerë nga organet kompetente gjyqësore të R.Sh”.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr. 9575, datë 17.12.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetas Znj. D.V, për marrjen e sigurimit të padisë dhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, Urdhër Largimit nr. 38, datë 04.07.2024 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë.

Ankuesja me shkresën datë 06.01.2025, drejtuar DVKM Tiranë, ka kërkuar zbatimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 17.12.2024.

DVKM Tiranë me shkresën nr. 166/1, datë 28.01.2025, drejtuar Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, ka kërkuar anulimin e shënimit në rubrikën “Njoftim në kufi”, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar gjyqësor për shtetasen Znj. D.V.

DVKM Tiranë me shkresën nr. 155/1, datë 30.01.2025, ka informuar ankuesen se është bërë anulimi i shënimit në rubrikën “Njoftim në kufi”, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar gjyqësor.

⁸ Referuar Certifikatës së Martesës, datë 13.08.2024, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile 332, të Bashkisë Shkodër, rezulton se D.V ka lidhur martesë me shtetasin A.U, në datë 22.07.2024.

Referuar informacionit të dhënë nga palët, rezulton se znj. D.V në datë 21.02.2025, ka riaplikuar për pajisje me leje qëndrimi, aplikim i cili është miratuar me datë 16.04.2025, me afat një vit.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Drejoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, kanë zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet për kufirin dhe migracionin, për shqyrtimin e aplikimeve për dhënien e lejes së qëndrimit dhe ka trajtuar aplikimet e ankueses sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga strukturat përgjegjëse që bëjnë vlerësimin e aplikimit për leje qëndrimi.

Në Kreun VI, të Udhëzimit të Përbashkët nr. 196, datë 14.10.2024 “Për bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurat e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt”, përcaktohet se:

1. Në vlerësimin e aplikimit për Leje Qëndrimi ose Leje Unike marrin pjesë strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor dhe qendror të kufirit dhe migracionit, strukturat përgjegjëse të informacionit kriminal në Policinë e Shtetit, si dhe strukturat përgjegjëse të Shërbimit Informativ të Shtetit.
2. Strukturat përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, sipas fushës së përgjegjësisë, aprovojnë dhe dërgojnë për vlerësim në formë elektronike pranë autoritetit qendror për kufirin dhe për migracionin, çdo aplikim të miratuar nga autoritet vendor për kufirin dhe migracionin, duke bërë komentet përkatëse në modulën e-Leje Qëndrimi të sistemit FER.
3. Struktura e migracionit në autoritetin qendror për kufirin dhe migracionin, sipas fushës së përgjegjësisë, trajton aplikimet në sistem, kryen verifikime të dokumenteve për raste ku kërkohet vlerësim i veçantë, duke proceduar rast pas rasti, si dhe dërgon elektronikisht për vlerësim tek strukturat përgjegjëse të SHISH-it dhe ato të informacionit kriminal pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit të gjitha aplikimet e rregullta.
4. Strukturat përgjegjëse pranë Shërbimit Informativ të Shtetit në nivel qendror dhe ato të informacionit kriminal pranë autoritetit qendror të Policisë së Shtetit, të ngarkuara për këtë qëllim, kryejnë verifikimet e nevojshme në bazat e tyre të të dhënave ndaj të huajve, të cilët kanë aplikuar për Leje Qëndrimi ose Leje Unike dhe bëjnë vlerësimin e tyre nëse janë dakord apo jo për lëshimin e lejes. Në rastet e vlerësimit negativ për lëshimin e saj, autoritetet e sipërcituara ia komunikojnë me shkresë zyrtare autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin referencën ligjore mbi të cilën bazojnë vendimin për refuzimin e aplikimit, si dhe afatin e refuzimit të hyrjes për shtetasin e huaj, nëse kjo është e nevojshme.
5. Autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin, referuar vlerësimeve sipas pikës 4, vendos për miratimin ose refuzimin e aplikimit për Leje Qëndrimi ose Leje Unike”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se strukturat për kufirin dhe migracionin, kanë trajtuar aplikimet e ankueses, e kanë informuar për refuzimin e lejes së qëndrimit dhe e kanë njohur me të drejtën për të kundërshtuar vendimmarrjen e tyre.

Në përgjigjet e dërguara nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe DVKM Tiranë, evidentohet se gjatë periudhës 2022-2024, janë pajisur me leje qëndrimi 197 shtetas nga Republika e Serbisë, dhe rezulton se nga ana e këtyre institucioneve, nuk ka pasur trajtim të pafavorshëm për ankuesen, për shkaqet e pretenduara prej saj, pasi nga të dy institucionet janë krijuar mundësitë për të aplikuar dhe për tu pajisur me leje qëndrimi, shtetasit me të njëjtën shtetësi si ankuesja, ndërkohë që arsyeja e refuzimit të aplikimit të ankueses që përbënte kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, rezulton se nuk është kryer nga DKM dhe DVKM Tiranë.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe DVKM Tiranë, në datë 18.10.2022, e kanë pajisur me leje qëndrimi ankuesen, në periudhën kur ka qenë në të njëjtat kushte siç ishte në periudhën kur i është refuzuar leja e qëndrimit në datë 04.07.2024, pra me statusin e ish konsulles dhe gazetares.

Referuar sa më sipër, Komisioneri nuk mund të vlerësojë arsyet e refuzimit të vendosur nga autoritetet që kanë kompetencë shqyrtimin e aplikimeve, për shkak të informacionit të klasifikuar, por edhe të diskrecionit që organet kanë në vlerësimin e rasteve, por vlerëson nëse autoritetet kanë zbatuar procedurat dhe legjislacionin, në lidhje me këto situata. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të sjellë nga palët, rezulton se institucionet kanë zbatuar legjislacionin në fuqi sipas, fushës që mbulojnë, dhe ankuesja është informuar në vijimësi për të drejtën e saj për të kundërshtuar administrativisht dhe në gjykatë, vendimmarrjen e DVKM-së dhe të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Gjithashtu, rezulton se të njëjtat institucione që kanë bërë trajtimin dhe refuzimin e aplikimeve për leje qëndrimi dhe bashkim familjar të znj. D.V, bazuar në diskrecionin dhe kompetencat e tyre, në datë 16.04.2025, kanë miratuar aplikimin e ankueses për leje qëndrimi, me afat një vit.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH dhe DVKM Tiranë, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH dhe DVKM Tiranë, kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases Znj. D.V nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA